

## Procedura e Licencimit dhe Përmbajtja e Licencave për Ngrohje Qendrore

**Merita Kostari,**  
**Kryesuese e Departamentit Ligjor dhe të Licencave**  
**Anëtare Bordi të ZRRE-së**

**Prishtinë, Shtator 2006**



ERO

# Procedura e Aplikimit për Licenca

- ❶ Afati për aplikim për licencë tek ZRRE-ja ka qenë **24 Qershor**;
- ❶ Afati për lëshimin e licencave- **24 Shtator**.
- ❶ Me datën **5 Maj** ne kemi mbajtur **tryezë pune** me **Ngrohtoret – “Termokos” dhe “Gjakova”**. Tryezë pune është mbajtur me qëllim që t’u lehtësohet aplikuesve procedura e aplikimit.
- ❶ Ngrohtoret në **Mitrovicë dhe Zveçan** nuk kanë marrë pjesë, edhe pse kanë qenë të ftuar.

## Procedura e Aplikimit per Licenca

- Duke filluar nga 24 Gusht ZRRE-ja ka kërkuar nga Aplikuesit (varësisht nga kompletimi i aplikacionit) që të botojnë në 2 gazeta ditore **përmbledhje rreth aplikacionit** që e kanë ushtruar dhe **informatën** që ZRRE-ja është **në proces të shqyrtimit të aplikacioneve**.
- Ngrohoret **“Termokos” dhe “Gjakova”** kanë kryer publikimin.
- Me 24 Gusht ZRRE-ja ka filluar me dërgimin e faturave për pagesën e taksave fillestare për shqyrtimin e aplikacioneve që paguhen në bazë të **Pasqyrës së Taksave (Rregulli i miratuar nga Bordi i ZRRE-së)**

# Procedura e Aplikimit per Licenca

## NGROHTORJA E QYTETIT “GJAKOVA”-SH.A

- Ka aplikur **me 23 Qershor** për licencat e: Gjenerimit, Shpërndarjes dhe Furnizimit Publik;
- Prej 23 Gusht e disa herë me vonë ZRRE-ja ka kërkuar dokumente shtesë ose informa që nevoiteshim dhe ato janë dërguar deri me datë 31 Gusht 2006, e **Leja e perkohshme e Mjedisit për Gjenerim** është dorëzuar me 18 Shtator 2006. Në vend të lejës Aplikuesi ka dorëzuar **Deklaratën e nënshruar dhe të vulosur** se ka aplikuar në MMPH dhe në momentin kur të leshohet leja, ajo do të dërgohet në ZRRE.
- ZRRE ka dërguar të gjitha draft licencat tek “Gjakova” dhe nuk ka pasë komente.



ERO

# Procedura e Aplikimit per Licenca

## NGROHTORJA E QYTETIT “TERMOKOS”- SH. A

- Ka aplikur me 26 Qershor 2006 për Licencë Gjenerimi, Shpërndarje dhe Furnizim Publik;
- Nga 23 Gusht e disa herë më vonë ZRRE ka kërkuar dokumente shtesë ose informata që nevojiteshim. Përfundimisht me datë 04 Shtator janë sjellë të gjitha dëshmitë e lartcekura, përveç **Lejes së Mjedisit** për gjenerim, për të cilën aplikuesi e ka dërguar **Deklaratën të nënshruar dhe vulosur** se ka aplikuar në MMPH dhe në momentin kur MMPH lëshon këtë Leje, do ti derëzohet në ZRRE.
- Termokos ka pranuar draft licencën nga ZRRE dhe nuk ka pas komente, përveç komentet verbale që menjëherë janë marrë parasysh.

## Licenca është...

Licenca është **përmbledhja e dispozitave relevante** që bazohen në:

- Ligjin e Energjisë,
- Ligjin e Ngrohjes Qendrore,
- Ligjin e Rregullatorit të Energjise Elektrike,
- Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë;
- Rregullit të Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorinë e Energjisë në Kosovë,
- Pasqyrën e Taksave;
- Rregullat tjera që janë miratuar nga Bordi i ZRRE- së në seancat paraprake publike.



ERO

## Baza ligjore ne dispozitat e Licences

- Format e licencave përmbajnë kushte të dosmodoshme për të licencuarin: p.sh – që të **veproi në përputhje** me të gjithë **legjislacionin** që aplikohet në Kosovë **në sektorin e energjisë** (Ligjet në fuqi dhe Rregullat e aprovuara nga ZRRE-ja në bazë të ligjeve, kodeve teknike, por edhe sipas ligjeve jasht sektorit të energjisë - **për ambient në Kosovë, ligjet për siguri në Punë dhe ligjet e punës.**
- I Licencuari duhet të mbaj **llogari të ndara** për shkak të **evitimit të subvencioneve ose ndër-subvecioneve** dhe ndikimit eventual në tarifa, dërgimi **i informatave ZRRE-së** dhe të tjera që janë objekt i këtij prezantimi.



## Baza ligjore në dispozitat e Licencës

### 1) Draft Licenca për Gjenerim me Kushte - per “Termokos dhe “Gjakova”

- **Pjesa I – Termat e Licencës** bazohen në Nenet 5.2 dhe 5.3 të Ligjit për Ngrohje Qendrore. Kohëzgjatja e licencës është **15 vjet** e vlerësuar **sipas kohëzgjatjes teknike të stacionit të gjenerimit** që përdoret për kryerjen e aktiviteteve (sipas ligjit – maximum 30 vjet);

-**Neni 1: Përkufizimet dhe interpretimet** (definicionet nga Ligji i Energjisë, Ligji i Ngrohjes Qendrore dhe Ligji i Rregullatorit të Energjisë);



## Baza ligjore në dispozitat e Licencës

- Neni 2: Llogaritë e veçanta për Biznesin e Gjenerimit të Energjisë Termale**- sipas Nenit 26.1 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë; Ky nen përmban kushtin kohor 12 muaj për implementim.
- Neni 3: Ndalimi i Subvencioneve dhe Ndër-subvencioneve** - sipas Nenit 23.2 (1) të Rregullit të Licencimit;
- Neni 4: Ndalimi i Diskriminimit** - sipas Neni 15.4 të Ligji mbi Rregullatorin e Energjisë (LRE);
- Neni 5: Pajtueshmëria me Kodin e Shpërndarjes, Kodin Matës dhe Rregullin për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji** , ky nen ka edhe **kushtin** ku ZRRE-ja mund ti jap një udhëzim **për afatin kohorë për implementim**; Bazohet në Nenin 15.2 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë, Nenin 1.4 e) të Rregullit për Licencimin dhe RKPFE;

# Baza ligjore në dispozitat e Licencës

## **Neni 6: Sigurimin i Karburantit**

Ky Nen bazohet në Ligjit mbi Ngrohjen Qendrore dhe Ligjin e Energjisë.

**Neni 7: Shëndeti dhe Siguria** - sipas Neneve 21 dhe 23.2 të Rregullit për Licencim;

**Neni 8: Mjedisi** - Sipas Nenit 11.4 dhe 21 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, Ligjeve dhe akteve nënligjore nga MMPH dhe përmban kushtin kohor që do të analizohet pas analizës së lejes që do të merret nga Aplikuesi ose si do të veprohet në mungesë të saj.

**Neni 9: Puna** - sipas Nenit 11.4 të Rregullit për Licencim;

**Neni 10: Regjistrimi dhe Tjetërsimi dhe heqja e Aseteve të të Licencuarit** - sipas Nenit 42 të Rregullit për Licencim;

## Baza ligjore në dispozitat e Licencës

**Neni 11: Obligimi i Sigurimit** - sipas Nenit 29.2 të Rregullit për Licencim dhe këtu është dhënë kusht 12 muaj për imeplementim;

**Neni 12: Ndryshimi në Kontrollin e të Licencuarit** - sipas Nenit 36 dhe 29.1 të Rregullit për Licencim;

**Neni 13: Sigurimi i Informacioneve ndaj ZRRE-së** -sipas Neneve 13.1 dhe 27.2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;

**Neni 14: Arsyet për Përfundimin, Tërheqjen dhe Modifikimin e Licencës** – Kapitulli 9 i Rregullit të Licencimit;

**Neni 15: Taksat** – sipas Pasqyrës se Taksave;

**Neni 16: Masat dhe Gjobat Administrative** – sipas Nenit 57 të Ligjit të Rregullatorit të Energjisë dhe draft Rregullit mbi Masat dhe Gjobat Administrative;

**Neni 17: Zgjidhja e Kontesteve** – sipas Nenit 2.1 i Rregullit për Zgjidhjen e Kontesteve.



### 2) Draft Licenca për Furnizim Publik me Kushte (për Termokos dhe Gjakova)

- **Pjesa I – Termat e Licencës** bazohen në nenin 16.2 të Ligjit mbi Energjinë, Neneve 5.2 dhe 5.3 të Ligjit mbi Ngrohjen Qendrore dhe kohëzgjatja e kësaj licence është 10 vjet (sipas Rregullit mbi Licencim dhe Nenit 31 të LRE);
- **Nenet tjera janë të njëjta si në Licencë Gjenerimi përpos që kjo licencë ka disa nene specifike për furnizim:**
  - **Nenit 6: Siguria dhe Mbrojtja e Furnizimit** (informimi i duhur i konsumatorëve etj)
  - **Neni 7: Qeverisja e Detyrimeve të të Licencuarit** (në mënyrë efikase, në përputhje me legjislacionin dhe kodet, përgatitja e kodeve përkatëse.



## Baza ligjore në dispozitat e Licencës

- **Neni 8: Furnizimi me Njehsorë** –sipas Ligjit të Ngrohjes Qendrore dhe Kodit Matës;
- **Neni 9: Procedurat për zbulim dhe parandalimin e vjedhjeve, dëmtimeve dhe ndërhyrjeve në njehsor** – Neni 28.7 të Rregullit mbi Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji dhe Ligji i Ngrohjes Qendrore;
- **Neni 10: Informacione të Tjera që u jepen Konsumatorëve** (ndërlidhet me Nenin 7 por më tepër sa i përket kontesteve dhe informimit në lidhje me këtë)
- Neni 5 :Pajtueshmëria me Kodin e Shpërndarjes, Rrjetit Elektrik, Kodin Matës dhe Rregullin mbi Kushtet Përgjithshme të Furnizimit me Enegjinë Elektrike** - sipas **Nenit** 15.2 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë dhe Nenit 1.4 e) të Rregullit për Licencim dhe Nenit 4.2 b) të RKPFE;

## Baza ligjore në dispozitat e Licencës

- Neni 6: Qeverisja e Detyrimeve të të Licencuarit - sipas Nenit 3 të Rregullit për Licencim;
  - **Neni 7: Mbrojtja dhe Siguria** - sipas Nenit 11.4 të Rregullit për Licencim;
  - **Neni 8: Standardet e Përgjithshme dhe Minimale të Përmbushjes** - sipas Nenit 19 të Rregullit për Licencim.
- Nenet tjera janë të njëjta si në licencën e gjenerimit përpos që në këtë licencë **mungon :Neni për Sigurimin e Karburantit, Neni sa i përket Mjedisit dhe Neni sa i përket obligimit të Sigurimit të aseteve.**

### 3) Draft Licenca për Shpërndarje me Kushte (për Temokos dhe Gjakova)

**-Pjesa I – Termat e Licencës** bazohen në Nenin 15.2 (a), Nenit 28.2 (h) dhe Nenit 37 të LRE dhe Nenit 16.2 të Ligjit mbi Energjinë, Nene 5.2 dhe 5.3 të Ligjit mbi Ngrohjen Qendrore dhe Rregullit për Licencim. Kohëzgjatja e kësaj licence është **15 vjet** bazuar në kërkesën e aplikuesit dhe vlersimit të ekspertit tonë për ngrohje qendrore.

**-Neni 5: Detyrimet e të Licencuarit lidhur me Pajisjet Matëse-**  
**Neni 6: Kyçja në Rrjetin e Shpërndarjes së Ngrohjes**—sipas Nenit 11 në Ligjin mbi Energjinë, Neneve 45 deri në 48 dhe 52 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë dhe të Ligjit mbi Ngrohjen Qendrore;

## Baza ligjore në dispozitat e Licencës

**Neni 7: Qasja dhe Shfrytëzimi i Rrjetit të Shpërndarjes së Ngrohjes** -Neneve 28 dhe 29 të Ligjit mbi Ngrohjen Qendrore.

**Neni 8: Plani Zhvillimor** –sipas Nenin 15.2 dhe 15.3 të Ligjit për Ngrohjen Qendrore, Nenin 8 të Ligjit mbi Energjinë dhe Nenin 24.3 të Rregullit mbi Licencim;

**Neni 11: Shfrytëzimi Shtesë ose Tjetërsimi i Aseteve Relevante** – që ZRRE-ja të informohet nëse asetet përdoren në mënyrë shtesë nga ajo që përfshihet në aktivitete të rregullta të shpërndarjes ose tjetërsohen).

**Neni 16: Sigurimi i Informacioneve për Operatorët e tjerë të Sistemit të Shpërndarjes** (kjo nënkupton p.sh. se Operatorët nga Prishtina dhe Gjakova shkëmbejnë informata sipas nevoje) Te gjithë nene tjera si licencat paraprake.

# Zyra e Rregullatorit për Energji



**FALEMINDERIT!**



Zyra e Rregullatorit për Energji

Rr.Hamdi Mramori Nr. 1

10 000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +381 (0) 38 247 615 ext. 101

Fax: +381 (0) 38 247 620

e-mail: [info@ero-ks.org](mailto:info@ero-ks.org)

[www.ero-ks.org](http://www.ero-ks.org) 17



ERO

[www.ero-ks.org](http://www.ero-ks.org)